



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:267501
Datë: 14.02.2025
Numri i dokumentit: 06850867

CAP.nr.2118/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË- me gjyqtarin individual Fatmir Baloku, në çështjen juridiko-civile përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (Kesco), me adresë Bulevardi “.....” nr..., Ndërtesa kati .. – Prishtinë, kundër debitorit M. F., me adresë në rr. “.....” Mitrovicë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1147/21, të datës 17.10.2024, me datë 06.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (Kesco), me adresë Bulevardi “....” nr., Ndërtesa Elektro Kosova, kati .. – Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1147/21, i datës 17.10.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.1147/21, të datës 17.10.2024, ka vendosur si në vijim: I.PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit M. F. nga Mitrovica, SHFUQIZOHET pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.1055/19 të datës 18.06.2019, i lejuar nga Përmbaruesi Privat A. M., me seli në Mitrovicë, dhe atë për shumën e borxhit prej 513.78 euro për periudhën prej dt. 26.12.2015 deri me dt. 31.12.2017. II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit si i pa bazuar, MBETET NË FUQI pjesa tjetër e urdhrimit të përmbaruesit privat A. M. me seli në Mitrovicë, P.nr.1055/19 të datës 18.06.2019, për shumën e borxhit prej 224.69 euro, për periudhën nga data 01.01.2018 deri me datën 10.05.2019. III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, URDHËROHET që paraprakisht të paguaj garancionin në të holla në shumën prej 224.69 euro, si parakusht për ushtrimin e ankesës, në qoftë se pala ankuese dështon të paguaj atë, ankesa do të konsiderohet se nuk është parashtruar fare.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e kreditorit të aprovohet si e bazuar, aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe çështja ti kthehet

gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim ose i njëjti të ndryshohet dhe të refuzohet prapësimi i debitorit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, e në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, me datë 18.06.2019, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit duke u bazuar në ekstraktin e verifikuar nga kreditori.

Përmbartuesi Privat me urdhrin për përmbartim P.nr.1055/19, të datës 18.06.2019, e ka lejuar propozimin për përmbartim.

Kundër urdhrin për përmbartim debitori me datën 01.10.2019 ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditori me datën 09.10.2019, ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.1147/21, të datës 17.10.2024, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke u bazuar në nenin 360 të LMD-së, *(duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi)*.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarit individual, vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.1 dhe par.2 të LPK-së, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbartimor sikurse në aktvendimin e ankimuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Në bazë të nenit 21 të LPP-së, organi përmbartues e cakton përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues dhe dokumentit të besueshëm. Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm, ku kjo parashihet në nenin 29 par.1 të LPP-së, e ku ceket se *“përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument*

i besueshëm , sipas këtij Ligji janë: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po qe se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2 Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3 Faturat”, dhe përmbajnë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 29 par.3 të po këtij ligji, sipas të cilit parashihet se “dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Po ashtu, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Kjo pasi që në bazë të shkresave të lëndës, shihet se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit përfshin periudhën nga data 26.12.2015 e deri me datë 10.05.2019, në shumë prej 738.47 euro, andaj kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur në bazë të nenit 360 par. 1, nënpar.1.1 të LMD-së, lidhur me parashkrimin e pjesshëm të borxhit në shumën prej 513.78 euro për periudhën kohore nga data 26.12.2015 e deri me datë 31.12.2017. Në anën tjetër, në raport me shumën e borxhit prej 224.69 euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2018 e deri me datë 10.05.2019, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit pasi që kreditori propozimin e tij e ka paraqitur me datën 18.06.2019, përkatësisht brenda afatit të paraparë me nenin 360 paragrafi 1, nënpar.1.1 të LMD-së, duke gjetur se borxhi për periudhën e lartcekur, nuk është parashkruar. Në lidhje me këtë pjesë të borxhit, rezulton se debitori nuk e ka provuar faktin se ndaj kreditorit e ka përmbushur këtë shumë të detyrimit në emër të borxhit.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarit individual vlerëson se pretendimet e kreditorit se sa i përket pagesave të bëra nga debitori kanë ndikuar në ndërprerjen e parashkrimit dhe pranimit të borxhit, nuk janë të bazuara për faktin se edhe pse debitori nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhë shihet se ka bërë disa pagesa paushalle, prapë nuk ka dëshmi se këto pagesa janë bërë në emër të borxhit paraprak, apo në emër të faturave për muajt vijues dhe se me vetë faktin se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar paraprakisht një marrëveshje për ri programim eventual të borxhit, këto pagesa nuk e kanë ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit, konform nenit 368 paragrafi 2 të LMD-së.

Se pagesat e kohëpaskohshme dhe në mënyrë paushalle nuk e ndërprejnë parashkrimin, këtë fakt e ka vërtetuar edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar vendimit të saj (aktgjykimit Rev.nr.148/2012, dt. 09.09.2013, faqja 3, pasuesi i katërt i aktgjykimit), ku parashihet se: *pagesat eventuale që janë bërë për këtë periudhë nga debitori në formë të ndonjë pagese në këste, nuk shkaktojnë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, nëse ato nuk i referohen ndonjë pagese të ndonjë fature fikse për muajin gjegjës, përveç nëse mes palëve ka marrëveshje për ri programim të borxhit, apo ka specifikime.*

Gjykata e Apelit, në rastin konkret konstaton se në shkresat e lëndës nuk figuron ndonjë marrëveshje për ri programim të borxhit, si dhe nuk ka specifikime të kërkesës për të cilën bëhet pagesa, që sipas nenit 368, par.1 dhe 2 të LMD-së do të rezultonin me pranimin e borxhit dhe ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit për debitorin.

Pagesat e kohëpaskohshme që debitori ka paguar në emër të borxhit si tërësi, nuk nënkupton pohim i borxhit, kështu duke ju referuar Aktgjykimit Rev.nr.211/2019, dt.13.08.2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku e njëjta ka mbajtur qëndrim se: *pohimi i bazës juridike të detyrimit pa pohimin e saktë, konkret dhe të qartë të lartësisë së detyrimit nga debitori (apo i padituri) nuk konsiderohet pohim i borxhit nga debitori, që do rezultonte me ndërprerje të rrjedhës së afatit të parashkrimit sipas nenit 368 par. 1 të LMD-së.* Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të

procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë, për çka edhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbartimore *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.2118/24, me datë 06.02.2025

Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v